



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR  
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA  
KAMËZ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

**Baza ligjore:** Neni 19, pikat 1, shkronja “i”, “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**VËREJ:**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 27 dhe ZAZ nr. 28.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz.

Data: . .2023 Nr: 00  
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 27 dhe KZAZ nr. 28 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës Zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Kamëz, u kontrolluan tabelat përmbledhëse përkatësisht ZAZ nr. 27 dhe ZAZ nr.28, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu dhe për këshillin, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës përkatëse, përveç rezultatit të QV-së nr. 1575/00 dhe 1597/02 në ZAZ-në nr. 27, që me vendim të KZAZ-së nr.27, kutia me fletë votimi për këshillin dhe për kryetarin janë shpallur kuti të parregullta.

Pranë KQZ, “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka depozituar ankimin me nr. 5291 Prot, datë 20.5.2023, me anë të së cilit kërkon që të përlllogaritet në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin Bashkiak Kamëz, edhe rezultati i QV nr. 1575/00 dhe 1597/02, KZAZ nr. 27.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, Qarku Kamëz, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## V E N D O S :

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Rakip Suli si Kryetar i Bashkisë Kamëz, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: . .2023 Nr:  
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: . .2023 Nr:  
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”



## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

#### BASHKIA KAMËZ, QARKU TIRANË



Lidhja 1

		<b>ZAZ 27</b>	<b>ZAZ 28</b>	<b>TOTALI</b>
1	Nr Zgjedhësve në listë	71.011	37.788	<b>108.799</b>
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	31.233	15.513	<b>46.746</b>
3	Vota të pavlefshme	693	434	<b>1.127</b>
4	Vota të vlefshme	30.540	15.079	<b>45.619</b>
1	Rakip Bajram Suli	17.736	9.880	<b>27.616</b>
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	1.222	757	<b>1.979</b>
3	Arjan Xhavit Hoxha	11.582	4.442	<b>16.024</b>
	<b>Totali i votave të vlefshme</b>	<b>30.540</b>	<b>15.079</b>	<b>45.619</b>



## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

#### BASHKIA KAMËZ, QARKU TIRANË



Lidhja 2

		ZAZ 27	ZAZ 28	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	71.011	37.788	<b>108.799</b>
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	30.981	15.513	<b>46.494</b>
3	Vota të pavlefshme	276	166	<b>442</b>
4	Vota të vlefshme	30.705	15.347	<b>46.052</b>
1	Bashkë Fitojmë	7.860	3.303	<b>11163</b>
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	12.544	7.373	<b>19917</b>
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	803	226	<b>1029</b>
4	Partia Republikane Shqiptare	824	308	<b>1132</b>
5	Partia Levizja e Legalitetit	735	234	<b>969</b>
6	Partia Demokracia Sociale	599	226	<b>825</b>
7	Aleanca Liberale e Djathtë	721	532	<b>1253</b>
8	Partia Socialdemokrate	1.682	780	<b>2462</b>
9	Partia Demokratike	2.320	1.154	<b>3474</b>
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	338	67	<b>405</b>
11	Fryma e Re Demokratike	1.352	712	<b>2064</b>
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	103	297	<b>400</b>
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	824	135	<b>959</b>
	<b>Totali i votave të vlefshme</b>	<b>30.705</b>	<b>15.347</b>	<b>46.052</b>